**VENDIM**
**Nr. 73, datë 6.12.2017**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "MBI PARIMET BAZË TË DREJTIMIT TË BANKAVE DHE DEGËVE TË BANKAVE TË HUAJA DHE KRITERET PËR MIRATIMIN E ADMINISTRATORËVE TË TYRE"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të nenit 24, pika 1, shkronja "c" dhe "ë" dhe pika 2, shkronja "b"; të nenit 40 shkronja "c" dhe të nenit 42 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre", miratuar me vendimin nr. 63, datë 14.11.2012 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4, pika 2, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) shkronja "c" ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"oreksi/toleranca ndaj rrezikut" është niveli i agreguar dhe llojet e rrezikut që banka është e gatshme/në gjendje të ndërmarrë, brenda kapacitetit të rrezikut, për arritjen e objektivave strategjikë të veprimtarisë dhe planit të biznesit të saj;"

ii) pas shkronjës "d", shtohet shkronja "e" me përmbajtjen e mëposhtme:

"kapaciteti i rrezikut" është niveli maksimal i rrezikut që banka mund të ndërmarrë, duke konsideruar mbështetjen tek kapitali, likuiditeti, kapaciteti huamarrës dhe kufijtë rregullatorë.";

b) Në nenin 5, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, togfjalëshi "tolerancën së tij" zëvendësohet me togfjalëshin "oreksin /tolerancën ndaj tij";

ii) shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Banka harton një politikë të veçantë për emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues, duke specifikuar kërkesat mbi diversifikimin e përbërjes së këshillit drejtues, në funksion të sigurimit të njohurive, kualifikimeve dhe eksperiencave kolektive të tij (këshillit drejtues), në fusha të ndryshme të drejtimit dhe të kontrollit.";

c) Në nenin 13, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, shtohet paragrafi "Kjo strukturë/njësi ka autoritetin, reputacionin, njohuritë dhe burimet e mjaftueshme, të cilat sigurojnë zbatimin e politikave të rrezikut dhe të kuadrit të administrimit të rreziqeve, si dhe të proceseve efektive të administrimit të rrezikut.";

ii) pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Struktura/njësia e administrimit të rrezikut është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollon, si dhe ka linjë të veçantë raportimi dhe varësie prej tyre. Në çdo rast, kjo strukturë bashkëvepron me linjat e biznesit /njësitë e brendshme, me qëllim arritjen e objektivave. Ndërveprimi midis funksioneve operacionale dhe strukturës/njësisë së administrimit të rrezikut duhet të ndihmojë në arritjen e objektivave të të gjithë stafit të bankës që është përgjegjës për administrimin e rreziqeve.";

iii) pika 4 ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Drejtuesi i strukturës/njësisë së administrimit të rrezikut duhet të ketë njohuri, pavarësi dhe eksperiencë të mjaftueshme për vendimet, të cilat prekin ekspozimin e bankës ndaj rreziqeve, si dhe raporton në mënyrë periodike në këshillin drejtues (duke i siguruar një informacion gjithëpërfshirës dhe të kuptueshëm këtij organi), në komitetin e rrezikut dhe tek drejtoria/drejtori i përgjithshëm ekzekutiv i bankës.";

iv) në pikën 5, pas togfjalëshit "banka gjatë aktivitetit të saj", shtohet togfjalëshi ", si dhe të kryejnë trajnime të rregullta.";

v) në pikën 6, pas togfjalëshit "konsideratat e përshtatshme për bankën", shtohet togfjalëshi ", si dhe jep rekomandimet e nevojshme për përmirësimet e kuadrit të administrimit të rrezikut dhe për masat korrigjuese për ndreqjen e shkeljeve në politikat, procedurat dhe kufizimet e rrezikut.";

vi) pas pikës 8 shtohen pikat 9 deri 19, me përmbajtjen e mëposhtme:

"9. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut përfshihet paraprakisht në hartimin e strategjisë së

rrezikut dhe siguron që banka ka krijuar procese efektive të administrimit të rrezikut. Kjo strukturë /njësi i siguron këshillit drejtues të gjithë informacionin e nevojshëm për çështjet që lidhen me rrezikun, me qëllim përcaktimin e nivelit të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut nga këshilli.

10. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson qëndrueshmërinë e strategjisë dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe siguron që oreksi/toleranca ndaj rrezikut të përshtatet në mënyrën e duhur me kufijtë specifikë të ekspozimeve ndaj rrezikut.

11. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson strategjitë e rrezikut të njësive të biznesit (duke konsideruar edhe objektivat e propozuar nga këto njësi) dhe ia paraqet këtë vlerësim këshillit drejtues, përpara se të marrë vendime mbi këto strategji. Objektivat e njësive të biznesit duhet të jenë të besueshëm dhe në përputhje me strategjinë e rrezikut të bankës.

12. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut përfshihet në vlerësimin e ndikimit të ndryshimeve të rëndësishme (materiale) dhe të transaksioneve jo të zakonshme mbi rrezikun e përgjithshëm të bankës dhe të grupit bankar/financiar, si dhe raporton gjetjet drejtpërdrejt tek këshilli drejtues, përpara se të merren vendimet mbi këto ndryshime apo transaksione.

13. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson ndikimin e rreziqeve të identifikuara, në aftësinë e bankës apo të grupit bankar/financiar për të administruar profilin e rrezikut, si dhe likuiditetin e bazën e qëndrueshme të kapitalit të tij, në rrethana normale dhe të pafavorshme.

14. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që rreziqet identifikohen, vlerësohen, maten, monitorohen, administrohen, zbuten dhe raportohen nga dhe tek njësitë përkatëse të bankës.

15. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që të analizohen transaksionet me personat e lidhur, si dhe të identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë të përshtatshme rreziqet që ato krijojnë për bankën.

16. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut siguron që të gjithë rreziqet e identifikuara të mund të monitorohen në mënyrë efektive nga njësitë e biznesit.

17. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut monitoron rregullisht profilin ekzistues të rrezikut të bankës dhe e shqyrton atë në kuadër të objektivave strategjikë të bankës dhe të oreksit/tolerancës ndaj rrezikut, duke informuar në mënyrë të plotë, gjithëpërfshirëse dhe të mjaftueshme këshillin drejtues.

18. Struktura/njësia e administrimit të rrezikut vlerëson mënyrat e mundshme për të zbutur rreziqet, si dhe i propozon këshillit drejtues planin e veprimeve të përshtatshme për zbutjen e rrezikut.

19. Bankat përcaktojnë në procedurat e tyre të brendshme, edhe rregullat për miratimin e vendimeve, mbi të cilat drejtuesi i strukturës /njësisë së administrimit të rrezikut ka shprehur opinion negativ. Këshilli drejtues komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë me drejtuesin e kësaj strukture/njësie mbi çështje me rëndësi të rrezikut, përfshirë edhe zhvillime që mund të mos jenë në përputhje me oreksin/tolerancën ndaj rrezikut dhe strategjinë e rrezikut të bankës.";

d) Në nenin 14, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Struktura/njësia e përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollon dhe ka autoritetin, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme.";

ii) në pikën 3, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "c/1" me përmbajtjen e mëposhtme:

"vlerësimin e ndikimit të mundshëm të çdo ndryshimi ligjor dhe rregullativ në veprimtarinë e bankës dhe në kuadrin e përputhshmërisë;";

e) Në nenin 15, pika 5, togfjalëshi "tolerancës së rrezikut" zëvendësohet me togfjalëshin "oreksit/tolerancës ndaj rrezikut,";

f) Në nenin 16, pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Administratori i bankës gëzon reputacion të lartë etik, nëse:

a) nuk është në ndjekje penale, në gjykim për vepra penale dhe i dënuar penalisht;

b) ka vepruar me kompetencë në ushtrimin e funksioneve dhe në përshtatje me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin e veprimtarisë së bankës (nëse është e aplikueshme);

c) ka treguar korrektësi në drejtim dhe, në veçanti, transparencë dhe bashkëpunim në marrëdhëniet me autoritetin mbikëqyrës dhe në qëndrimin ndaj masave mbikëqyrëse dhe ndëshkimore të tij (autoritetit mbikëqyrës);

d) ka arritur rezultate të larta dhe ka shfaqur integritet profesional gjatë ushtrimit të funksioneve apo eksperiencave të mëparshme;

e) nuk ka të dhëna mbi gjendjen financiare, të cilat mund të cenojnë reputacionin e tij ose të dhëna të tjera, të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme mbi reputacionin e këtij individi; si dhe

f) ndaj tij nuk janë marrë masa disiplinore të largimit nga puna ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e aplikimit/vlerësimit, përveç rasteve kur masa

disiplinore është konsideruar në kundërshtim me ligjin, me vendim gjykate të formës së prerë.";

g) Në nenin 17, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, pas togfjalëshit "me pikën 2 ose 3 të këtij neni" shtohet togfjalëshi ",brenda 30 ditëve pune nga data e marrjes së vendimit të organit vendimmarrës.";

ii) në pikën 2, pas shkronjës "k" shtohet shkronja "l" me përmbajtjen e mëposhtme:

"vërtetimi ose raporti i kredimarrësit nga regjistri i kredive ose një dokument ekuivalent i lëshuar nga organet kompetente të shtetit të huaj.";

h) Në nenin 18 kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në pikën 1, pas shkronjës "a", shtohen shkronja "a/1" dhe "a/2" me përmbajtjen e mëposhtme:

"a/1) një analize të përgatitur nga banka që propozon administratorin, mbi përshtatshmërinë e njohurive profesionale të tij (administratorit), lidhur me pozicionin për të cilin propozohet, e cila bazohet kryesisht në:

i) kohëzgjatjen, natyrën dhe kompleksitetin e eksperiencave të mëparshme të administratorit të propozuar;

ii) kompetencat, vendimmarrjet dhe përgjegjësitë e ushtruara në pozicionet e mëparshme të punës;

iii) njohuritë e përfituara nga këto pozicione pune, mbi institucionet financiare dhe rreziqet që përballen këto institucione;

iv) numrin e punonjësve që ka pasur në varësi;

v) argumentet dhe arsyet e përshtatshmërisë së administratorit të propozuar, me veprimtarinë, funksionet dhe detyrat që do të kryejë; si dhe

vi) vlerësimin e bankës mbi rezultatet e arritura dhe integritetin profesional të shfaqur, gjatë ushtrimit të funksioneve apo eksperiencave të mëparshme;

a/2) një vlerësimi të përgatitur nga banka, mbi kohën e nevojshme në dispozicion, që administratori i propozuar do t'i dedikojë përmbushjes së funksionit dhe përgjegjësive të tij, i cili (vlerësimi) duhet të bazohet kryesisht në angazhimin e tij si rrjedhojë e numrit të pozicioneve që ai mund të mbajë edhe në struktura të tjera drejtuese të filialeve të të njëjtit grup bankar apo në subjekte ku banka zotëron pjesëmarrje të rëndësishme."

ii) pas pikës 4, shtohet pika 5 dhe 6 me përmbajtjen e mëposhtme:

"5. Në rast se administratori mban disa pozicione në struktura të tjera drejtuese të filialeve të të njëjtit grup bankar apo në subjekte ku banka zotëron pjesëmarrje influencuese, Banka e Shqipërisë i kërkon bankës që administratori të lirohet nga një ose disa funksione, të cilat pengojnë punën e administratorit me kohë të plotë.

6. Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin e administratorit, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim, nuk plotësohen nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën.";

i) Në nenin 19, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Emërtimi i nenit 19 "Miratimi në rast ndryshimi të pozicionit të administratorëve", ndryshon në "Miratimi në rastet e ndryshimit të pozicionit të administratorëve ose riemërimit të tyre";

ii) Në pikën 1, fjala "riemërim" do të zëvendësohet me "emërim" dhe fjala "riemërimi" do të zëvendësohet me "emërimi";

iii) Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"1/1. Banka, në rastet e riemërimit të administratorit në të njëjtin pozicion, paraqet në Bankën e Shqipërisë një kërkesë me shkrim për miratimin e këtij riemërimi. Kjo kërkesë shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e riemërimit, sipas shkronjës "a", të pikës 2, të nenit 17 të kësaj rregulloreje;

b) CV-në e përditësuar, të plotësuar sipas aneksit nr. 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

c) një informacion/relacion të detajuar për vlerësimin dhe kontributin e administratorit, në drejtimin efektiv të bankës (për shembull një vlerësim të performancës së drejtuesit ekzekutiv, të kontributit të anëtarit të këshillit drejtues në mbledhjet e këtij organi etj.);

d) informacione të tjera shtesë, të cilat mund të gjykohen të nevojshme.";

iv) pika 2, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Banka e Shqipërisë mund të refuzojë dhënien e miratimit paraprak për emërimin e administratorit në një pozicion të ndryshëm nga ai ekzistues dhe/ose për riemërimin e tij, kur mbi bazën e vlerësimeve të saj, çmon se kualifikimet dhe përvoja e tij nuk janë të përshtatshme me pozicionin e propozuar si administrator apo kontributi i tij nuk vlerësohet i konsiderueshëm.";

j) Pas nenit 19, shtohet neni 19/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Neni 19/1

**Procesi i rivlerësimit të administratorëve**

1. Bankat kryejnë rivlerësimin e përshtatshmërisë së administratorëve të miratuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, të paktën një herë në vit, si dhe në rastet kur gjykohet e nevojshme, bazuar në rrethana apo fakte të veçanta.

2. Bankat, nëpërmjet procesit të rivlerësimit të përshtatshmërisë së administratorëve të miratuar, sigurojnë plotësueshmërinë në vazhdimësi të kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Bankat dokumentojnë procesin e rivlerësimit të përshtatshmërisë për të gjitha kategoritë e administratorëve, respektivisht, të anëtarëve të këshillit drejtues, anëtarëve të komitetit të kontrollit dhe të drejtuesve ekzekutivë.

4. Bankat parashikojnë detyrimin për të gjithë administratorët, të cilët duhet të njoftojnë bankën për çdo rrethanë apo fakt që ka ndikim të rëndësishëm në përshtatshmërinë e tyre, për të realizuar funksionet, për të cilët ata janë miratuar ose të konfirmojnë, të paktën një herë në vit, që nuk kanë ndryshuar të dhënat mbi të cilat është dhënë miratimi paraprak nga Banka e Shqipërisë.";

k) Në nenin 22, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

"Banka e Shqipërisë ndërpret procedurat e shqyrtimit të kërkesës për miratimin për të përfunduar me të tretët marrëveshje për transferimin e funksioneve dhe përgjegjësive për drejtimin e saj, në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni i kërkuar për miratim nuk plotësohen nga banka brenda 6 (gjashtë) muajve pas datës së aplikimit fillestar për marrjen e miratimit. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të kërkesës për miratim, Banka e Shqipërisë njofton me shkrim bankën.";

l) Në nenin 23, kryhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Në pikën 1, pas togfjalëshit "kompleksitetin e veprimtarisë së tyre", shtohet togfjalëshi ", si dhe në veçanti strukturën organizative që siguron një ndarje të qartë të detyrave, përgjegjësive dhe raportimit, sipas modelit të tre linjave të kontrollit.";

ii) Pas pikës 1, shtohen pikat 2 dhe 3 me përmbajtjen e mëposhtme:

"2. Bankat, si pjesë të raportit vjetor të tyre, publikojnë një deklaratë të veçantë për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut të ndërmarrë, në përmbushje të objektivave të tyre strategjikë. Deklarata rishikohet nga këshilli drejtues mbi baza vjetore dhe në çdo rast që evidentohen ndryshime të rëndësishme (materiale) në veprimtarinë e tyre, të cilat mund të ndryshojnë qasjen/vendimmarrjen e këshillit drejtues për oreksin/tolerancën ndaj rrezikut.

Bankat sigurojnë që deklarata e oreksit /tolerancës ndaj rrezikut, të adresojë çështjet e kulturës dhe oreksit/tolerancës ndaj rrezikut dhe kapaciteteve të rrezikut të bankës, gjatë ushtrimit të veprimtarive bankare e financiare.";

m) Në tabelën e aneksit 1, pas pikës 6 "Eksperienca në punë", shtohen dy rreshta me përmbajtjen e mëposhtme:

| |
|---|
| PJESËMARRJE NË KËSHILLA DREJTUESE/NË SHOQATA PROFESIONISTËSH<br>1. (lutemi listoni shoqëritë/shoqatat ku jeni ose keni qenë anëtar i këshillave drejtues, datat e pjesëmarrjes etj.) |
| Emri dhe adresa e punëdhënësit |

n) Pas aneksit 3, shtohet aneksi 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

ANEKSI 4

PËRBËRJA E KËSHILLIT DREJTUES TË BANKËS DHE INTERESAT PRIVATË TË ANËTARËVE TË TIJ, SIPAS PËRCAKTIMEVE TË NENIT 44, PIKA 2[1] TË LIGJIT NR. 9662, DATË 18.12.2006, "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR[2]

(Ky formular plotësohet nga banka në momentin e aplikimit të një ose disa anëtarëve të këshillit drejtues, për të vlerësuar strukturën aktuale të këshillit drejtues të bankës)

| **Nr.** | **Emri i anëtarit të këshillit drejtues** | **Pozicioni aktual i punësimit të anëtarit të këshillit drejtues dhe emri i punëdhënësit** | **Marrëdhëniet e interesave private të anëtarit të këshillit drejtues me:** | | | **Afati i emërimit në këshillin drejtues të bankës (datë, muaj, vit-datë, muaj, vit)** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Bankën** | **Aksionarët që ushtrojnë kontroll mbi bankën** | **Drejtuesit ekzekutivë** | |
| 1. | | | | | | |
| 2. | | | | | | |
| 3. | | | | | | |
| 4. | | | | | | |
| 5. | | | | | | |
| 6. | | | | | | |

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në 30 prill 2018.

KRYETARI
**Gent Sejko**

[*] Interesat privatë të anëtarit të këshillit drejtues me bankën dhe/ose me aksionarin/ët që ushtron/jnë kontroll mbi bankën dhe/ose me drejtuesit ekzekutivë të bankës, të përcaktuara sipas nenit 44, pika 2 të ligjit për bankat janë:
- marrëdhënie pasurore ose tregtare të drejtpërdrejta ose të tërthorta të çdo lloj natyre,
- çdo marrëdhënie tjetër juridiko – civile,
- dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale,
- negocime të mundshme për punësim apo për çdo lloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për administratorin në të ardhmen, pas lënies së detyrës si administrator, të kryera nga ai gjatë ushtrimit të detyrës si administrator në bankë,
- angazhime në veprimtari të tjera private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura,
- marrëdhënie familjare ose të bashkëjetesës.

[*] Lutemi plotësoni përgjigjet në kutiza me "po" ose "jo". Në rast të plotësimit me "po" të jepen shpjegime për llojin e marrëdhënies së interesave privatë të anëtarit të këshillit drejtues sipas (*) më lart.".